



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 4062/7 Prot.

Pogradec, më 11 . 11 . 2025

VENDIM

NR. 112 , DATË 10 . 11 . 2025

“PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z. FATOS HAMZA, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË TRAJTIMIT SHËNDETËSOR, JASHTË VENDIT TË DJALIT TE TIJ TË MITUR, ALTEO HAMZA”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 7, nenit 54, nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, Ligji nr.10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligj nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën shoqërore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 16.05.2024, “Për një shtesë në Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.141, datë 27.12.2024, “Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2025” si dhe duke marrë në konsideratë urgjencën e situatës shëndetësore të të miturit Alteo Hamza, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. T’i akordojë ndihmë financiare, në vlerën prej 300.000 (treqind mijë) lekë, familjes së z. Fatos Hamza, për shpenzimet e trajtimit shëndetësor jashtë vendit të djalit te tij të mitur, Alteo Hamza.
2. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i miratuar i vitit 2025.
3. Ngarkohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, pranë Bashkisë Pogradec, për zbatimin e këtij vendimi.



4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,”
Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 23 vota

2.Vota Pro 23

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 11.11.2025